


# PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

2025\*

INSTAT publikon të dhënat përfundimtare të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), për vitin 2024 dhe ato gjysmëfinale për vitin 2025. PBB-ja me çmime korrente u vlerësua në 2,648,505 milion lekë për vitin 2025 dhe 2,517,280 milion lekë në vitin 2024.

Ekonomia shqiptare shënoi një rritje në terma reale prej 3,66 % në vitin 2025, nga 4,03 % në vitin 2024.

**FIG. 1 PBB DHE RITJIA EKONOMIKE, 2021 – 2025\***



2025\* Të dhëna gjysmëfinale


## Metoda e prodhimit

Përsa i përket strukturës së PBB-së, sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2025, e zënë "Shërbimet gjithsej" me 49,10 %, duke shënuar një rritje në terma realë me 5,83 %. "Industria" përbën 10,08% të PBB-së dhe ka shënuar ulje në terma realë -3,72%. "Ndërtimi" zë 12,56 % dhe ka shënuar rritje me 4,11%. "Bujqësia, pyjet dhe peshkimi" përbën 14,59 % të PBB -së dhe ka shënuar ulje prej -2.50% në terma realë.

Kontributi sipas aktiviteteve ekonomike paraqitet si më poshtë:

"Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia" me 1,65 pikë përqindje, Ndërtimi" me 0,50 pikë përqindje, "Tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor" me 0,47 pikë përqindje, "Aktivitete të pasurive të paluajtshme" me 0,42 pikë përqindje, "Aktivitete të informacionit dhe komunikacionit" me 0,06 pikë përqindje, "Industria" me -0,41 pikë përqindje, "Bujqësia, pyjet dhe peshkimi" me -0,38 pikë përqindje. "Taksa neto mbi produktet" kanë kontribuar me 1,16 pikë përqindje në rritjen reale të ekonomisë.

**FIG. 2 KONTRIBUTI I DEGËVE KRYESORE TË EKONOMISË NË NORMËN REALE TË RITJES SË PBB 2025\*, NË PIKË PËRQINDJE**



**TAB. 1 TREGUESIT SIPAS AKTIVITETEVE EKONOMIKE, GRUPIMI A10**

| A10        | Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev. 2                                     | Vlerat me çmime korente<br>Në Milion Lekë |                  | Vlerat me<br>çmime të<br>vitit të<br>mëparshëm | Rritja<br>reale<br>(%) | Struktura e PBB<br>(%) |               | Kontributi  |
|------------|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|------------------|------------------------------------------------|------------------------|------------------------|---------------|-------------|
|            | Gjithsej                                                                 | 2024                                      | 2025*            | 2025*                                          | 2025*                  | 2024                   | 2025*         | 2025*       |
| <b>A1</b>  | Bujqësia, pyjet dhe peshkimi                                             | 385,346                                   | 386,369          | 375,731                                        | -2.50                  | 15.31                  | 14.59         | (0,38)      |
| <b>A2</b>  | Industria gjithsej                                                       | 279,250                                   | 266,857          | 268,854                                        | -3.72                  | 11.09                  | 10.08         | (0,41)      |
| <b>2a</b>  | nga cila: Industria përpunuese                                           | 175,404                                   | 171,139          | 172,939                                        | -1.41                  | 6.97                   | 6.46          | (0,10)      |
| <b>A3</b>  | Ndërtimi                                                                 | 307,532                                   | 332,666          | 320,179                                        | 4.11                   | 12.22                  | 12.56         | 0,50        |
| <b>A4</b>  | Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor     | 475,508                                   | 513,825          | 487,400                                        | 2.50                   | 18.89                  | 19.40         | 0,47        |
| <b>A5</b>  | Informacioni dhe komunikacioni                                           | 61,123                                    | 63,599           | 62,568                                         | 2.36                   | 2.43                   | 2.40          | 0,06        |
| <b>A6</b>  | Aktivitetet financiare dhe të sigurimit                                  | 39,658                                    | 43,125           | 41,060                                         | 3.53                   | 1.58                   | 1.63          | 0,06        |
| <b>A7</b>  | Aktivitete të pasurive të paluajtshme                                    | 127,329                                   | 141,881          | 137,849                                        | 8.26                   | 5.06                   | 5.36          | 0,42        |
| <b>A8</b>  | Aktivitete shkencore, profesionale , administrative dhe mbështetëse      | 173,571                                   | 177,689          | 174,272                                        | 0.40                   | 6.90                   | 6.71          | 0,03        |
| <b>A9</b>  | Administrata publike;Arsimi; Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale | 285,480                                   | 311,950          | 326,942                                        | 14.52                  | 11.34                  | 11.78         | 1,65        |
| <b>A10</b> | Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi                  | 44,903                                    | 48,293           | 47,898                                         | 6.67                   | 1.78                   | 1.82          | 0,12        |
|            | <b>Vlera e Shtuar Bruto me çmime bazë</b>                                | <b>2,179,700</b>                          | <b>2,286,253</b> | <b>2,242,753</b>                               | <b>2.89</b>            | <b>86.59</b>           | <b>86.32</b>  | <b>2,50</b> |
|            | Taksa neto mbi produktet                                                 | 337,579                                   | 362,252          | 366,661                                        | 8.62                   | 13.41                  | 13.68         | 1,16        |
|            | <b>PBB ME ÇMIMET E TREGUT</b>                                            | <b>2,517,279</b>                          | <b>2,648,505</b> | <b>2,609,414</b>                               | <b>3.66</b>            | <b>100.00</b>          | <b>100.00</b> | <b>3,66</b> |

2025\* Të dhëna gjysëmfinale


## Metoda e Shpenzimeve

Sipas PBB-së me metodën e shpenzimeve, konsumi gjithsej përbën peshën kryesore të PBB-së me metodën e shpenzimeve, në ekonomi me 82,20 %. Ky komponent u rrit në terma nominalë 6,31 % dhe 4,66 % në terma realë. Konsumi final i popullatës zë 68,63 % të konsumit gjithsej, i ndjekur nga konsumi final i administratës publike me 12,89 % dhe konsumi i institucioneve jo-ftim prurëse në shërbim të familjeve (IJFSHF) me 0,68 %.

Në vitin 2025, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks, i cili përbën 24,23 % të PBB-së, u rrit në terma nominalë me 4,98 % dhe në terma realë me 3,30 % krahasuar me vitin 2024.

Eksportet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 7,41 % në terma nominalë dhe 7,42 % në terma realë, ndërkohë Importet e mallrave dhe shërbimeve u rritën me 3,70 % në terma nominalë dhe me 3,62 % në terma realë, krahasuar me vitin 2024.

**FIG. 3 STRUKTURA E PBB-SË ME METODËN E SHPENZIMEVE, NË %**




**TAB. 2 TREGUESIT E KOMPONENTËVE KRYESORË TË PBB-SË ME METODËN E SHPENZIMEVE**

| Treguesit e PBB-së                              | Vlerat me çmime korente |           | PBB me çmime të vitit të mëparshëm | Rritja reale (%) | Struktura e PBB (%) |        | Kontributi |
|-------------------------------------------------|-------------------------|-----------|------------------------------------|------------------|---------------------|--------|------------|
|                                                 | 2024                    | 2025*     |                                    |                  | 2024                | 2025*  |            |
| <b>Konsumi Final</b>                            | 2,047,950               | 2,177,177 | 2,143,449                          | 4.66             | 81.36               | 82.20  | 3.79       |
| <b>Konsumi Final i Popullatës</b>               | 1,723,481               | 1,817,736 | 1,782,033                          | 3.40             | 68.47               | 68.63  | 2.33       |
| <b>Konsumi Final i Administratës Publike</b>    | 309,475                 | 341,407   | 344,674                            | 11.37            | 12.29               | 12.89  | 1.40       |
| Konsumi Individual                              | 141,450                 | 155,094   | 161,075                            | 13.87            | 5.62                | 5.86   | 0.78       |
| Konsumi Kolektiv                                | 168,025                 | 186,313   | 183,599                            | 9.27             | 6.67                | 7.03   | 0.62       |
| <b>Konsumi i Institucioneve Jo-fitimprurëse</b> | 14,994                  | 18,034    | 16,741                             | 11.65            | 0.60                | 0.68   | 0.07       |
| <b>Formimi Bruto i Kapitalit Fiks</b>           | 611,363                 | 641,838   | 631,538                            | 3.30             | 24.29               | 24.23  | 0.80       |
| <b>Ndryshimet e gjëndjeve</b>                   | 31,315                  | (24,584)  | (20,719)                           |                  | 1.24                | (0.93) | (2.07)     |
| <b>Eksporti neto</b>                            | (173,349)               | (145,926) | (144,853)                          | (16.44)          | (6.89)              | (5.51) | 1.13       |
| <b>Eksportet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>  | 913,588                 | 981,241   | 981,385                            | 7.42             | 36.29               | 37.05  | 2.69       |
| Eksportet e mallrave                            | 169,050                 | 153,063   | 155,791                            | (7.84)           | 6.72                | 5.78   | (0.53)     |
| Eksportet e shërbimeve                          | 744,538                 | 828,178   | 825,593                            | 10.89            | 29.58               | 31.27  | 3.22       |
| <b>Importet e mallrave e shërbimeve (fob)</b>   | 1,086,937               | 1,127,166 | 1,126,238                          | 3.62             | 43.18               | 42.56  | 1.56       |
| Importet e mallrave                             | 731,470                 | 735,527   | 731,060                            | (0.06)           | 29.06               | 27.77  | (0.02)     |
| Importet e shërbimeve                           | 355,467                 | 391,639   | 395,178                            | 11.17            | 14.12               | 14.79  | 1.58       |
| <b>PRODHI I BRENDSHËM BRUTO</b>                 | 2,517,279               | 2,648,505 | 2,609,414                          | 3.66             | 100.00              | 100.00 | 3.66       |

## Metoda e të Ardhurave

Sipas kësaj metode, fitimi operativ bruto (B.2g), i cili shpreh vlerën që mbetet pas zbritjes nga vlera e shtuar të kompensimit të punonjësve dhe taksave neto në prodhim, përbën peshën 58,87% të PBB-së.

**FIG. 4 STRUKTURA E PBB-SË ME METODËN E TË ARDHURAVE, NË %**



Kompensimi i punonjësve, i cili përfshin shpërblimin gjithsej, në para ose në natyrë, që punëdhënësi i paguan punonjësit në këmbim të punës së kryer nga ky i fundit, zë 28,98 % të PBB-së, i ndjekur nga taksat mbi produktet me 13,70%.

**TAB. 3 TREGUESIT E KOMPONENTËVE KRYESORË TË PBB-SË ME METODËN E TË ARDHURAVE**

| Kodi ESA         | Treguesi                                           | 2021             | 2022             | 2023             | 2024             | 2025*            | Struktura në PBB (%) |
|------------------|----------------------------------------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|----------------------|
| <b>D.1</b>       | <b>Kompensimi i punonjësve</b>                     | <b>469,811</b>   | <b>506,207</b>   | <b>620,796</b>   | <b>691,813</b>   | <b>767,433</b>   | <b>28.98%</b>        |
| <b>D.11</b>      | Paga dhe shpërblime                                | 402,578          | 434,435          | 531,474          | 595,510          | 661,161          | 24.96%               |
| <b>D.12</b>      | Kontribute për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore | 67,233           | 71,772           | 89,322           | 96,299           | 106,272          | 4.01%                |
| <b>D.21</b>      | Taksa mbi produktet                                | 270,619          | 294,548          | 305,781          | 338,047          | 362,799          | 13.70%               |
| <b>D.29</b>      | Taksa të tjera mbi prodhimin                       | 27,913           | 28,641           | 33,333           | 42,383           | 43,351           | 1.64%                |
| <b>D.31</b>      | Subvencione mbi produktet                          | -66              | -219             | -508             | -468             | -547             | -0.02%               |
| <b>D.39</b>      | Subvencione të tjera mbi prodhimin                 | -255             | -1,205           | -241             | -1,056           | -1,922           | -0.07%               |
| <b>B.2g/B.3g</b> | Fitimi operativ bruto / Të Ardhura mikse bruto     | 1,102,197        | 1,322,587        | 1,406,026        | 1,446,563        | 1,477,391        | 55.78%               |
| <b>B.1g</b>      | <b>PROD HIM I BREND SHËM BRUTO</b>                 | <b>1,870,218</b> | <b>2,150,559</b> | <b>2,365,187</b> | <b>2,517,279</b> | <b>2,648,505</b> | <b>100.00%</b>       |

2025\* Të dhëna gjysëmfinale

### Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara vjetore sipas aktiviteteve ekonomike janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT:

[Produkti i brendshëm bruto](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Produkti i brendshëm bruto](#)

# Metodologjia

## Metodologji dhe klasifikime

Llogaritjet e PBB-së mbështeten metodologjikisht në konceptet bazë të Sistemit European të Llogarive (ESA 2010) dhe të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA 2008) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Sistemi evropian i llogarive kombëtare dhe rajonale është korniza për matjen e aktiviteteve ekonomike dhe financiare të një sistemi ekonomik, komponentëve të tij dhe lidhjeve midis tyre në një periudhë kohe të dhënë (zakonisht një vit ose një tre-mujor). Transaksionet e kryera nga agjentët ekonomikë në lidhjet e tyre me njësitë e tjera rezidente ose jo rezidente në territorin ekonomik janë objekt i matjeve në llogaritë kombëtare.

Klasifikimet e përdorura në Llogaritë Kombëtare janë:

- Nomenklatura e veprimtarive ekonomike Rev.2.0 (Nace Rev.2.0-eng) ;
- Nomenklatura e produkteve (NP);
- Klasifikimi i konsumit individual sipas përdorimit (COICOP);
- Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit (COFOG).

### Burimet e të dhënave

Për vlerësimet e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative.

Burimet statistikore përfshijnë të dhënat e siguruar nga regjistrime dhe anketa të ndryshme mbi njësitë ekonomike ose familjet, ndër të cilat mund të përmendim: Regjistri i Ndërmarrjeve; Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave; Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve; Anketa e Tregtisë me Pakicë; Anketa e Buxhetit të Familjeve; Anketa e Forcave të Punës; Anketa të Statistikave të Çmimeve, etj.

Burimet administrative përfshijnë të dhëna administrative të mbledhura nga institucione të tjera për qëllime të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim: Pasqyrat financiare vjetore; Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH); Statistika financiare monetare; Bilanci i Pagesave; Statistika fiskale të qeverisë; Statistika të tregtisë së jashtme; Të dhëna mbi energjinë elektrike dhe të produkteve energjitike etj.

### Politikat revizionuese

Të dhënat e publikuara revizionohen mbështetur në politikat revizionuese të llogarive kombëtare. Vlerësimet vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto dhe komponentëve të tij janë subjekt i dy tipeve të revizionimit: të zakonshme dhe të veçanta. Për më tepër informacion referoju linkut:

<https://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/#tab4>

### Revizionime të zakonshme:

Revizionimet e zakonshme të PBB-së me baza vjetore janë rezultat i përditësimeve dhe plotësimit të burimeve ekzistuese të të dhënave me informacionin më të fundit për një vit të caktuar "t".

### Revizionime të veçanta:

Revizionimet e veçanta vijnë si rezultat i përfshirjes së burimeve të reja të të dhënave statistikore e administrative dhe përmirësimi i atyre ekzistuese; përmirësimit të teknikave statistikore dhe metodave të përpilimit të të dhënave për Llogaritë Kombëtare; ndryshimit të metodologjisë për shkak të standarteve të reja të Sistemit të Llogarive Kombëtare (SNA dhe ESA). Link: <https://www.instat.gov.al/al/temat/ekonomi-dhe-financ%C3%AB/llogarit%C3%AB-komb%C3%ABtare-gdp/#tab4>

## Përkufizime

**Produkti i Brendshëm Bruto (PBB):** Produkti i brendshëm bruto, vlerësuar me çmimet e tregut, është rezultati final i aktivitetit të prodhimit nga njësitë rezidente prodhuese gjatë një viti. PBB llogaritet sipas metodës së prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave.

PBB me metodën e prodhimit, është i barabartë me shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ndryshme të aktiviteteve, duke shtuar tatimet e taksat e duke i zbritur subvencionet mbi produktet (të cilat nuk u janë shpërndarë sektorëve apo degëve të aktivitetit);

PBB me metodën e shpenzimeve është i barabartë me përdorimet finale të brendshme të produkteve e shërbimeve (konsumi final efektiv, formimi bruto i kapitalit fiks, ndryshimet e gjendjeve), plus eksportet, minus importet.

PBB me metodën e të ardhurave llogarit vlerën e gjithë prodhimeve dhe shërbimeve që krijohen në një ekonomi gjatë një periudhe të caktuar, zakonisht një vit, duke u fokusuar në grumbullimin e të ardhurave që gjenerohen nga faktorët e prodhimit.

**Prodhimi:** Aktivitet i ushtruar nën kontrollin dhe përgjegjësinë e një njësie institucionale që kombinon burimet në fuqi punëtore, kapital dhe produkte e shërbime për të prodhuar produkte ose kryer shërbime. Proceset e pastra natyrore pa ndërhyrjen ose kontrollin e njeriut nuk bëjnë pjesë në prodhim. Ekzistojnë tre lloje të prodhimit: prodhim tregu; prodhim i prodhuar për konsum final vetjak dhe prodhim tjetër jo-tregu.

**Konsumi i ndërmjetëm:** Vlera e produkteve ose shërbimeve të përdorura pjesërisht ose plotësisht gjatë procesit të prodhimit. Përdorimi i aktiveve fikse të vëna në punë nuk merret parasysh; ai evidentohet në konsumin e kapitalit fiks.

**Vlera e shtuar bruto:** Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB dhe llogaritet si diferencë midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

PBB nominale mat vlerën e produkteve për një periudhë të caktuar kohore, me çmimet e periudhës në të cilin prodhohet produkti (çmimet e tanishme).

PBB reale mat produktin gjithsej të prodhuar në një ekonomi, për një periudhë të caktuar kohore, por duke marrë parasysh çmimet e një viti bazë (të dhënë-mundet me qenë viti paraardhës ose cili vit caktohet si vit bazë).

**Taksat mbi produktet dhe importin:** Taksat mbi produkte janë taksat e pagueshme për njësi të disa mallrave dhe shërbimeve si Taksa mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza, taksa dhe taksa doganore mbi importet.

**Subvencione në produkte:** Subvencionet në produkte janë pagesat e pakthyeshme që njësitë e administratës publike bëjnë tek ndërmarrjet si një shumë e caktuar parash për njësi të një malli ose shërbimi. Subvencionet në importe konsistojnë në subvencionimin e mallrave ose shërbimeve që bëhen të pagueshme kur malli kapërcen kufirin e territorit ekonomik ose kur shërbimet i janë kaluar njësive institucionale rezidente.

**Kompensimi i punonjësve** përkufizohet si shpërblimi total, në para ose në natyrë, që punëdhënësi i paguan punonjësit në këmbim të punës së kryer nga ky i fundit, gjatë periudhës kontabël. Kompensimi i punonjësve përfshin pagat dhe kontributet sociale të punëdhënësve.

**Fitimi operativ bruto (B.2g)** është diferenca që mbetet pas zbritjes nga vlera e shtuar (me çmime bazë) të kompensimit të punonjësve dhe i taksave dhe subvencioneve të tjera në prodhim. Fitimi operativ i të vetëpunësuarve quhet "E ardhur mikse bruto (B.3g)", sepse ajo gjithashtu përmban kompensim për punën e personave të vetëpunësuar dhe anëtarët e familjes së tyre.

**Taksa të tjera mbi prodhimin** janë taksa që bizneset duhet të paguajnë si rezultat i angazhimit në prodhim, pa marrë parasysh sasinë ose vlerën e mallrave dhe shërbimeve që prodhojnë ose shesin.

**Subvencionet mbi prodhimin** janë ndihma financiare që qeveritë ofrojnë bizneset për të mbështetur prodhimin e mallrave dhe shërbimeve. Këto subvencione kanë si qëllim të inkurajojnë prodhimin, të ulni koston e prodhimit, ose të ndihmojnë në zhvillimin e sektorëve të caktuar ekonomikë.

**Konsumi Final:** Konsumi Final është një nga komponentët kryesorë të PBB. Ky konsiston në mallrat dhe shërbimet e përdorura nga familjet individuale ose komunitetet dhe llogaritet si shumë e konsumit final të familjeve, konsumit final të administratës publike dhe konsumit final të Institucioneve Jo-Fitimprurëse në Shërbim të Familjeve (IJFSHF).

**Konsumi final i familjeve:** Llogarit të gjitha mallrat dhe shërbimet që përdoren direkt për të plotësuar kërkesat individuale të familjeve rezidente.

**Konsumi final i administratës publike dhe institucioneve jo fitim prurëse:** Përmban vlerën e shërbimeve jotregtare të kryera nga administrata publike dhe nga institucionet jofitimprurëse në përfitim të komuniteteve ose grupe familjesh. Kjo llogaritet si diferencë midis prodhimit të administratës publike dhe IJFSHF dhe vlerës së prodhimit tregtar.

**Eksportet neto:** Eksportet neto llogariten si diferencë midis eksportit të mallrave dhe shërbimeve (f .o .b) dhe importit të mallrave dhe shërbimeve (f .o .b).

**Formimi Bruto i Kapitalit Fiks:** Konsiston në shpenzimet e kryera për kapitale të reja ose për shpenzime të tjera specifike kryer nga prodhuesit në sende ose shërbime me qëllim që të mbajnë, rritin ose zgjerojnë kapacitetin e tyre prodhues ose që të krijojnë kushte të reja përpunimi në të ardhmen.

**Ndryshimi i gjendjeve:** Përcaktohet si diferencë midis gjendjeve të inventarit dhe në proces të aktiveve qarkulluese në fund dhe në fillim të vitit. Gjendjet përfshijnë: materiale të para dhe materiale të tjera; prodhime, punime shërbime në proces; produkte të gatshme e gjysëm të gatshme, mallra, kafshë , etj.

Të ardhurat kombëtare bruto përfshijnë të gjitha të ardhurat e fituara nga banorët dhe bizneset e një vendi, duke përfshirë edhe ato të fituara jashtë vendit.

**Çmim bazë:** Shuma që prodhuesi merr nga blerësi për njësi të produktit apo shërbimit të prodhuar, pa tatimet dhe subvencionet mbi produktin. Çmimi bazë përjashton shpenzimet e transportit të faturuara më vete.

**Çmimet e tregut:** janë çmimet pasi shtohen taksat mbi produktet minus subvencionet mbi produktet.

**Çmime korrente:** Çmimet e periudhës referuese. Ato përfaqësojnë çmimin e paguar për të mirat dhe shërbimet në kohën e prodhimit ose të konsumit.

**Çmime konstante:** Vlerësimet me çmime konstante janë në vlerë reale pra të korrigjuara për ndryshimet në çmime në lidhje me një vit bazë. Ato janë një mënyrë për të matur ndryshimin real në prodhim.